

ABSTRAKT

Mbrojtja e pronësisë sipas të drejtës pozitive në Kosovë dhe problemet praktike në vërtetimin e të drejtës së pronësisë

Kandidate: Erzë Mustafa

Mentori: Prof.Asoc.Dr. Haxhi Gashi

E drejta pronësore bënë pjesë në të drejtën sendore, të cilat jo vetëm që paraqesin kategori të veçantë të të drejtave subjektive-civile, por ato kanë edhe një rëndësi të veçantë në vete. Një grumbull ligjesh, rregulloresh, udhëzimesh administrative, praktikash të gjykatave dhe direktivash kombinohen për të krijuar një sistem të komplikuar dhe në dukje të pakapshëm për përcaktimin e kontesteve ndaj pronësisë së pronës së paluajtshme në Kosovë. Në nivelin më të lartë, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ndikojnë në të drejtat pronësore.

Në këtë temë fokusi është njohja dhe studimi i gjithanshëm i shumë çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë fillimisht me nocionin e pronësisë, me mbrojtjen e saj, të drejtat e pronarëve etj. Në këtë aspekt, gjyqtarët luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në promovimin e drejtësisë në secilin sistem juridik. Në rastin kur një individ është i privuar nga të drejtat pronësore të garantuara në Konventë, neni 13 garanton të drejtën “*për mjet efektiv juridik pranë autoriteteve vendore.*” dhe kur ai mjet përfshinë gjykatat, çdo gjykim duhet të jetë i drejtë sipas nenit 6 të Konventës.

Nisur nga objekti i studimit dhe kërkimeve në punën e bërë për punimin e kësaj teme, kemi përdorur metodat më bashkëkohore të punës teorike dhe asaj praktike, duke përdorur një literaturë të konsiderueshme dhe bashkëkohore, duke u shërbyer me ligjet dhe kodet e vendit si dhe duke bërë krahasime lidhur me rastet pronësore, metodat të cilat janë përdorur janë: *metoda hulumtuese, metoda përshkruese, metoda e analizës teorike si dhe metoda e studimit të rastit.*

Si përmbledhje, kjo temë përmbanë sfidat me të cilat përballen gjykatat lidhur me vërtetimin e pronësisë, problemet lidhur me shqyrtimin e provave, vlerësimin e tyre në mënyrë të duhur, sfida e vendosjes meritorë të çështjes në mungesë të provave nga të cilat mund të kuptojmë në mënyrë të qartë se në praktik hasim në probleme të mëdha dhe të një rëndësie të pakontestueshme, për arsye se një numër si madh i popullësisë nuk kanë njohuri për të drejtat, detyrat dhe autorizimet që mund ti ndërmarin lidhur me pronën e tyre.